

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5706
E mërkurë, 20 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Rriten pensionet



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR 'EPOKËN E RE', MUHARREM NITAJ

KOALICIONI PO FUNKSIONON, S'KA FTOHJE TË RAPORTEVE



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka hedhur poshtë mundësinë që çështja e taksës ta ketë lëkundur partneritetin e koalicionit qeverisës. Ai ka vlerësuar se koalicioni është duke funksionuar mirë dhe nuk

mund të flitet për ftohje të raporteve në mes të drejtuesve të tij. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nitaj ka thënë se qëndrimet për taksën janë ndryshim në metodologjinë se si do të arrihet deri te caku kryesor që është marrëveshja

përfundimtare Kosovë - Serbi. Ai ka deklaruar se ideja për krijimin e një qeverie gjithëpërfshirëse është hajgare. Kurse sa iu përket zgjedhjeve, Nitaj ka thënë se në këtë kohë nuk janë të përshtatshme për Republikën e Kosovës

LIGJI PËR QEVERINË DO TA ZVOGËLOJË NUMRIN E MINISTRIVE

Kryeministri Ramush Haradinaj ka marrë pjesë të martën në takim të Komisionit Qeveritar për Hartimin e Projektligjit për Qeverinë. Ai ka thënë se është i inkurajuar me punën që ka bërë komisioni në këtë drejtim. Ndërkaq Besnik Tahiri, Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore, ka thënë se ky ligj trajton numrin e zëvendësministrave, të ministrive, njëkohësisht edhe të zëvendëskryeministrave



Haradinaj priti në takim delegacionin e MCC-së nga Washingtoni

AKTUALE

HAREMI I MOGERINIT, ME KALORËS TË LODHUR!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

KDI-ja: GJAKOVA, KOMUNA MË TRANSPARENTE, PASOHE TË RAHOVECIT

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT RRIT NUMRIN E AUDITIMEVE TË PERFORMANCËS

EKONOMI

MINISTRI LLUKA U JEP MIRËNJOHJE MINATORËVE TË 'TREPÇËS'

EDHE DY INVESTITORË PËRMBUSHIN KRITERET TEKNIKE, PLANIFIKOJNË INVESTIM 225 MILIONË EURO



SPORT

MAJLINDA, MEDALISTJA E OLIMPIADAVE POLICORE

BERISHA: ME PËRKRAHJEN E 'DARDANËVE' DO TA MPOSHTIM RUMANINË

SONTE ATLETICO - JUVE DHE SCHALKE - CITY

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ambasada Amerikane reagon për djegien e mandateve nga opozita

TIRANË, 19 SHKURT - Ambasada Amerikane shprehet se "një demokraci e shëndetshme kërkon një opozitë që funksionon në mënyrë konstruktive brenda institucioneve kushtetuese. Kërcënimet nga Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe parti të tjera opozitare, për t'i braktisur

mandatet e tyre në parlament, minojnë parimet bazë të demokracisë dhe sabotojnë përparimin e rëndësishëm që Shqipëria ka arritur në zbatimin e ligjit dhe qeverisjen e përgjegjshme. Shtetet e Bashkuara iu bëjnë thirrje të gjithë deputetëve të ngrihen mbi sherret politike, t'i refuzojnë

thirrjet për t'i braktisur mandatet e tyre dhe t'i mbrojnë idealet dhe parimet që janë me rëndësi thelbësore për çdo demokraci të fortë", thuhet në deklaratë. "Nëse dështoni ta bëni punën tuaj, do t'i zhgënjoni njerëzit të cilëve keni privilegjin t'u shërbeni", thuhet në reagimin e Ambasadës Amerikane.



Pushteti në kërkim të kandidatit konsensual, opozita në fushatë



Derisa partitë e koalicionit qeveritar në Maqedoninë Veriore vazhdojnë konsultimet për gjetjen e një kandidati të përbashkët për president shteti për zgjedhjet që do të mbahen më 21 prill, opozita tashmë ka nisur fushatën me kandidaten e saj që ka zgjedhur në konventën e së shtunës në Strugë

SHKUP, 19 SHKURT - Partitë e koalicionit qeveritar vazhdojnë konsultimet për gjetjen e një kandidati të përbashkët për president shteti për zgjedhjet që do të mbahen më 21 prill. Pas takimit me kryetarin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, njëherësh kryetar i Lidhjes Social Demokratike (LSDM), ka thënë se nga e marta do t'i takojë edhe drejtuesit e partive të tjera, Menduh Thaçin, kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Afrim Gashin e Alternativës (parti e re e dalë

nga Lëvizja Besa), por edhe ato të opozitës shqiptare, Bilall Kasamin e Lëvizjes Besa dhe Zijadin Selën të Aleancës për Shqiptarët.

Këto dy të fundit nuk e kanë përjashtuar mundësinë që të dalin me një kandidat shqiptar, por kryeministri Zaev synon edhe mbështetjen e tyre në përpjekjen e tij për të siguruar një mbështetje sa më të gjerë për kandidatin e pushtetit. Zaevi ka thënë se, përveç takimeve me drejtues të partive, po zhvillohen edhe anketa për të parë se cili nga kandidatët e mundshëm qëndron më së miri. "Analizat dhe

anketat të cilat i bëjmë gjatë tërë kësaj periudhe jemi marrë vesh t'i shqyrtojmë bashkërisht pasi ato na ndihmojnë për gjetjen e kandidatit pas të cilit do të qëndrojnë të gjithë, si maqedonasit, shqiptarët dhe bashkësitë e tjera etnike. Mendoj se kemi shanse t'i çojmë përpara aspiratat tona për një kandidat të përbashkët. Besoj se kjo i duhet vendit tonë për ta dëshmuar përkushtimin tonë për forcimin e demokracisë dhe të shtetit në përgjithësi pasi jeni në periudhën kur presin edhe çeljen e negociatave për anëtarësimin në BE, si dhe përfundimin e

procesit të ratifikimit të protokollit për anëtarësim në NATO nga parlamentet e shteteve anëtare të Aleancës", ka deklaruar kryeministri Zaev. Për rëndësinë e daljes së partive në pushtet me një kandidat të përbashkët apo konsensual ka folur edhe kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, duke theksuar se kjo, para së gjithash, do të ishte në dobi të shtetit. "E rëndësishme është që të respektohet vullneti i shumicës së qytetarëve të vendit, por edhe porosia e cila do të jepet të jetë edhe në dobi të shtetit, si dhe te partitë politike që përfaqësojnë", ka deklaruar

kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, pas takimit të një dite më parë me kryeministrin Zoran Zaev, por pa saktësuar nëse në këtë takim është folur për emra konkretë.

BDI-ja më parë kishte përmendur emrat e disa personaliteteve maqedonase dhe shqiptare, por që menjëherë ishin hedhur poshtë nga LSDM-ja, ndërsa më pas Ahmeti kishte thënë se partia e tij mund të dilte e vetme në zgjedhje, pasi nuk do të pranonte një kandidat që del nga kongreset e LSDM-së. E derisa partitë e tjera janë në kërkim të kandidatit për të parin e shtetit opozita, nga ana tjetër, veç ka nisur fushatën me kandidaten e saj që ka zgjedhur në konventën e së shtunës në Strugë.

Profesoresha Gorgana Siljanovska do të garojë për postin e presidentes nga radhët e VMRO-DPMNE-së. Ajo tashmë ka realizuar takimet e para me qytetarë, por nuk kanë munguar as akuzat mes saj dhe pushtetit, i cili nuk e sheh të denjë për t'i përfaqësuar të gjithë qytetarët meqë është e ndikuar nga politikantët e ish-kryeministrit të arratisur, Nikolla Gruevski.

Fushata zgjedhore për presidencialet zgjat 20 ditë dhe, nëse asnjëri nga kandidatët nuk fiton mbi 50 për qind të votave, atëherë votohet pas dy javësh, apo më 5 maj, për dy kandidatët me numrin më të madh të votave në rrethin e parë. Zgjedhjet do të jenë të vlefshme nëse në votime dalin 40 për qind e trupit të përgjithshëm votues.

Talat Xhaferi viziton Bullgarinë

Shkup, 19 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, do të qëndrojë në vizitë pune në Bullgari, ku do të jetë i pranishëm gjatë

aktit të ratifikimit të Protokollit për aderimin e Maqedonisë së Veriut në NATO në Kuvendin e Bullgarisë, që është paralajmëruar për sot (e mërkurë). Pas

ratifikimit, kreu i Kuvendit do të takohet me kryetaren e Kuvendit të Bullgarisë, Cveta Karajançeva, me të cilën bashkë do të japin deklaratë për medi-

ume. Në kuadër të vizitës është parashikuar edhe takim me zëvendëskryeministren dhe ministren e MPJ-së, Ekaterina Zaharieva.



Kryeministri Ramush Haradinaj është i gatshëm t'i respektojë kërkesat e partnerëve të koalicionit për zgjedhje të parakohshme

Haradinaj: Për zgjedhje nuk duhet të bëhemi nervozë

Kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar të martën se nëse partnerja e madhe e koalicionit, PDK-ja, kërkon zgjedhje të reja, do ta respektojë kërkesën e saj. Ai ka thënë se askush nuk duhet të bëhet nervoz për zgjedhje ndonëse, sipas tij, vendi nuk duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Haradinaj nuk e ka mohuar që qëndrimin për taksën për produktet serbe po e mban edhe për shkak të votave

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se nëse dikush prej partnerëve të koalicionit qeverisës kërkon zgjedhje, do ta respektojë vullnetin e tyre. Në një konferencë për medie, pas mbledhjes së Qeverisë, ai ka thënë se është kundër mbajtjes së zgjedhjeve, por nëse në Kuvend bëhen 61 vota, vendi mund të shkojë në zgjedhje. "Nuk jemi parë me kryetarin Veseli dhe nuk më ka kërkuar mbajtjen e zgjedhjeve, por nëse ma kërkon, unë e respektoj, sepse është e drejtë legjitime për të shkuar në zgjedhje, pra nëse e vlerëson kështu njëri nga partnerët e koalicionit", ka thënë Haradinaj, duke mohuar se me votat e AAK-së dikush mund ta rrëzojë Qeverinë.

Ai nuk ka dashur të komentojë shumë deklaratën e kryeparlamentarit Veseli në përvjetorin e shpalljes së pavarësisë, për mundësinë e rrëzimit të Qeverisë. "Kryetari Veseli na nderoi me një fjalë dhe nuk mund ta komentoj fjalën e tij. Ajo është një ditë festive dhe zakonisht në këto festa ndonjë porosi e kësaj natyre shkon. Unë e di pse po pyetni. Në organizim të kësaj ngjarje i kemi disa ngarkesa, që janë edhe logjistike dhe të tjera. Zgjedhjet mund të vijnë çdo ditë.

Nuk është thënë se Kosova bën përjashtim. Edhe Kosova është shoqëri demokratike. Për zgjedhje nuk ka nevojë të bëhemi nervozë dhe as ta rrisim nervozën. Mjafton të merren vendime politike, të bëhen 61 deputetë dhe kaq. Nuk ka nevojë askush të bëjë trauma të tjera", është shprehur ai, duke mohuar mundësinë se ai po dëshiron ta çojë vendin në zgjedhje. "Unë nuk jam i gatshëm të shkoj në zgjedhje. Jam i gatshëm të punoj, sepse e kam marrë mandatin për këtë gjë, por nëse Kuvendi ashtu vendos, kuptohet se e respektoj atë vendim. Nuk ka të bëjë me gatishmëri, se ky është një proces i ditur. Nëse nesër thirret një seancë dhe Kuvendi i ka 61 vota mosbesimi për Qeverinë,

kuptohet se shkojmë në zgjedhje", ka thënë Haradinaj. I pyetur nga gazetarët nëse për taksën po këmbëngul për të mirën e vendit apo për shkak të votave, i pari i Qeverisë ka thënë

se këtë po e bën për të dyja. "Për të dyja. Nuk ndahen, por kësaj here, shikoni, ne jemi në politikë gjithë. Nuk e mohoj se çdo vendim imi ka implikime zgjedhore", është shprehur Haradinaj.

Kreu i Qeverisë i ka ftuar LDK-në dhe LV-në të bashkohen në procesin e dialogut dhe pas këtij procesi të shkohet në zgjedhje. "Nëse ata e shohin se zgjedhjet janë të nevojshme, ata nuk i largojnë zgjedhjet duke marrë pjesë në dialog. Ata mund t'i përshpejtojnë këto zgjedhje, por derisa ne jemi në procese kaq të rënda, është e pashpjegueshme shkuarja në zgjedhje. Nëse ne heqim disa tema të rënda para vetes, shkojmë në zgjedhje tamam të lira dhe demokratike, pa presionin e temave të rënda për vendin. Mendoj se e kundërta ishte dashur të ndodhë, që edhe LDK-ja dhe LV-ja të kyçen në platformë të dialogut dhe t'i heqim këto tema para vetes si Kosovë", ka thënë ai, duke shtuar se zgjedhjet e ardhshme duhet të jenë për vende të punës, për arsim më të mirë dhe për shëndetësi më të mirë.

Ahmeti: I themi PDK-së se me ndihmën tonë nuk do ta rrëzojë Qeverinë

Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti, ka reaguar ndaj opinionëve të analistëve për përfshirjen e mundshme të PSD-së në Qeveri. Ai ka thënë se nuk ka pasur as edhe një takim apo diskutim për këtë gjë. Ahmeti ka bërë me dije se ia kanë bërë të qartë edhe LDK-së dhe LV-së se nuk do ta ndihmojmë Listën Serbe për ta rrëzuar Qeverinë

për shkak të taksës. "Po lexoj në media se analistët po thonë se e parashikojnë prishjen e koalicionit dhe qeveri të re (pa zgjedhje) me LDK-në dhe PSD-në. Përderisa për LDK-në nuk mund të flas, sa i përket PSD-së mund të konfirmoj se nuk ka pasur asnjë takim apo diskutim për këtë gjë. Ne kemi dhënë dhe vazhdojmë të japim mbështetje politike për taksën dhe jemi

pjesë e delegacionit shtetëror për dialogun. I kemi thënë edhe LDK-së dhe LV-së, se nuk do ta ndihmojmë Listën Serbe për ta rrëzuar Qeverinë për shkak të taksës. Tani i themi edhe PDK-së se me ndihmën tonë nuk do ta rrëzojë e as kërcënojë AAK-në si presion ndaj kryeministrit për ta hequr taksën", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Universiteti i Prishtinës mbajti mbledhje përkujtimore në nderim të Idriz Ajetit



PRISHTINË, 19 SHKURT - Në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të martën është organizuar mbledhje përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së akademik Idriz Ajetit, i cili është ndarë nga jeta më 13 shkurt, në moshën 102-vjeçare.

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Marjan Dema, vlerësoi lart veprimtarinë e akademik Ajetit, i cili në periudhën e

viteve 1973-1975 shërbeu rektor i UP-së. "Ndonëse akademik Ajeti u nda fizikisht nga kjo jetë, figurat si ai janë të përjetshme dhe shërbejnë si frymëzim për pasardhësit për dekada e shekuj me radhë. Kontributi i tij disadekadash në Universitetin e Prishtinës ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e institucionit tonë. Akademik Ajeti me veprimtarinë e tij në arsimin e lartë dhe në akademi na la një thesar të çmuar pas vetës", tha Dema.

Për veprimtarinë e akademik Idriz Ajetit foli prof. dr. Bardh Rugova, shef i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë. "Idriz Ajeti është një ndër gjuhëtarët pionier të Kosovës, gjurmët e të cilit janë gjithkund ku vendi ka shënuar ndonjë të arritur", tha Rugova. Ai i njoftoi të pranishmit që Salla Solemne e Fakultetit të Filologjisë këtë të premte, me vendim të Këshillit të Fakultetit, ka marrë emrin "Salla Idriz Ajeti".

Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

Koalicioni po funksionon,

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka hedhur poshtë mundësinë që çështja e taksës ta ketë lëkundur partneritetin e koalicionit qeverisës. Ai ka vlerësuar se koalicioni është duke funksionuar mirë dhe nuk mund të flitet për ftohje të raporteve në mes të drejtuesve të tij. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nitaj ka thënë se qëndrimet për taksën janë ndryshim në metodologjinë se si do të arrihet deri te caku kryesor që është marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi. Ai ka deklaruar se ideja për krijimin e një qeverie gjithëpërfshirëse është hajgare. Kurse sa i përket zgjedhjeve, Nitaj ka thënë se në këtë kohë nuk janë të përshtatshme për Republikën e Kosovës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 19 SHKURT - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, të martën ka mohuar pretendimet se ka ftohje të raporteve në mes të liderëve kryesorë të koalicionit qeverisës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se koalicioni qeverisës është duke funksionuar mirë. Sipas Nitajt, qëndrimet për taksën janë ndryshim në metodologjinë se si do të arrihet deri te caku kryesor që është marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi. "Nuk besoj se mund të flitet për ftohje. Unë më shumë këtë e shoh ndryshim në metodologjinë se si do të arrihet deri te caku kryesor që është marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Koalicioni është duke funksionuar mirë. Këto janë qëndrime që dallojnë në metodologjinë e veprimeve", është shprehur ai, duke shtuar se nuk është kuptuar drejt kërkesa e partnerëve për heqjen e taksës. "Në fakt, kjo taksë është përgjigje ndaj agresivitetit të Serbisë dhe influencës ruse në këtë territor. Jam i bindur se partnerët do ta kuptojnë këtë të vërtetë dhe do të jenë edhe ata po aq të interesuar që të ndalet ndikimi rus në këtë pjesë të Ballkanit. Edhe partnerët e koalicionit po bëjnë të pamundurën që të jenë në unison. Nuk e di si do të zhvillohen proceset tutje, por e di se nuk do të pranohet që Serbia t'i vendosë kushte Kosovës", ka theksuar Nitaj.

Ai është deklaruar kundër idesë për krijimin e një qeverie gjithëpërfshirëse, duke thënë se një gjë e tillë është hajgare. "Analistët atë punë kanë. Për hir të së vërtetës, një numër jo i vogël i tyre pak dinë ose flasin me mendjen e tjetërkujt. Unë

dëgjova se një gjë e tillë është duke e kërkuar LDK-ja dhe, me gjasë, ky parashikim i analistëve atje e ka burimin. Se si veprohet tutje, vendos AAK-ja, por unë nuk i besoj kësaj ideje dhe më duket hajgare", ka thënë Nitaj. Kurse sa i përket zgjedhjeve, ai ka vlerësuar se në këtë kohë nuk janë të përshtatshme për Kosovën. "Ne jemi përballë proceseve më të rëndësishme për vendin e dikush bën kalkulime për pushtet dhe nuk jep pesë pare nëse kjo e vonon Kosovën në proceset jetike për integrimin e vendit në strukturat euroatlantike. Ç'është kjo farë meseleje, që ky vend të mos e kuptojë njëherë se zgjedhjet mbahen çdo katër vjet. Ky është realiteti. Nëse të tjerët paskan vendosur ta çojnë vendin në zgjedhje, AAK-ja nuk e ka asnjë arsye elektorale të mos e pranojë këtë sfidë. Zgjedhjet në këtë kohë janë të dëmshme për vendin, jo për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)", ka deklaruar Nitaj.

"Epoka e re": Z. Nitaj, AAK-ja dhe kryeministri Haradinaj janë të vendosur që taksë të mbetet në fuqi pavarësisht prej kërkesës së ShBA-së për pezullimin e saj. Por, pjesa tjetër e koalicionit është për pezullimin e taksës. Ka mundësi që në ditët në vijim të arrihet një konsensus brenda koalicionit qeverisës sa i përket taksës në mënyrë që të mos rrezikohet partneriteti dhe miqësia me Amerikën?

Nitaj: Nuk jam shumë i sigurt se është kuptuar drejt kërkesa e partnerëve për heqjen e taksës. Vendimi për tarifën ka qenë i imponuar nga Serbia dhe nuk është orientuar kundër partnerëve, as kundër Bashkimit Evropian, as kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në fakt, kjo taksë është përgjigje ndaj agresivitetit të Serbisë dhe influencës ruse në këtë territor. Jam i bindur se partnerët do ta



s'ka ftohje të raporteve

kuptojnë këtë të vërtetë dhe do të jenë edhe ata po aq të interesuar që të ndalet ndikimi rus në këtë pjesë të Ballkanit. Edhe partnerët e koalicionit po bëjnë të pamundurën që të jenë në unison. Nuk e di si do të zhvillohen proceset më tutje, por e di se nuk do të pranohet që Serbia t'i vendosë kushte Kosovës. Ajo është agresorja. Dhe nëse dikush duhet t'i parashtrijë kushte dikujt, ajo është Kosova, jo Serbia.

"Epoka e re": Deklarimet e fundit për taksën kanë krijuar përshtypjen në opinion se ka ftohje të raporteve në mes të partnerëve kryesorë të koalicionit qeverisës. Mund të tejkalohen këto mospajtime?

Nitaj: Nuk besoj se mund të flitet për ftohje. Unë më shumë këtë e shoh ndryshim në metodologjinë se si do të arri-

het deri te caku kryesor që është marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Për ne kanë rëndësi qëndrimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. Ju e keni dëgjuar kërkesën e fundit të presidentit Trump për njohje. Ky është synimi i të gjithë neve.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh këtë si dhe kërkesën e liderit të koalicionit Kadri Veseli për pezullimin e taksës, edhe sa mund të funksionojë koalicioni PAN?

Nitaj: Koalicioni është duke funksionuar mirë. Këto janë qëndrime që dallojnë në metodologjinë e veprimeve. Unë nuk mund të paragjykoj nëse mund të funksionojë ose jo koalicioni. Ajo është një marrëveshje politike. Partnerët e këtij koalicioni edhe mund ta

shfuqizojnë atë. Nuk jam në kokën e askujt për të ditur se cilat janë planet e tij apo atyre.

"Epoka e re": Analistët politikë parashikojnë prishjen e koalicionit dhe krijimin e një qeverie të re gjithëpërfshirëse. AAK-ja, a do të jetë pjesë e një qeverie të tillë?

Nitaj: Analistët atë punë kanë. Për hir të së vërtetës, një numër jo i vogël i tyre pak dinë ose flasin me mendjen e tjetërkujt. Unë dëgjova se një gjë të tillë është duke e kërkuar LDK-ja dhe, me gjasë, ky parashikim i analistëve aty e ka burimin. Se si veprohet më tutje, vendos AAK-ja, por unë nuk i besoj kësaj ideje dhe më duket hajgare.

"Epoka e re": Do të ketë zgjedhje të reja në vjeshtën e këtij viti?

Nitaj: Llafë nëpër kafene.

Gjithçka është e mundur. Edhe mund të ketë, edhe mund të mos ketë. Unë nuk e kam fuqinë për të parashikuar. Zgjedhjet, në këtë kohë, nuk janë të përshtatshme për Kosovën. Ne jemi përballë proceseve më të rëndësishme për vendin e dikush bën kalkulime për pushtet dhe nuk jep pesë pare nëse kjo e vonon Kosovën në proceset jetike për integrimin e vendit në strukturat euroatlantike. Ç'është kjo farë meseleje, që ky vend të mos e kuptojë njëherë e përgjithmonë se zgjedhjet mbahen çdo katër vjet. Ky është realiteti. Nëse të tjerët paskan vendosur ta çojnë vendin në zgjedhje, AAK-ja nuk e ka asnjë arsye elektorale të mos e pranojë këtë sfidë. Zgjedhjet në këtë kohë janë të dëmshme për vendin, jo për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit rrit numrin e auditimeve të performancës

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Auditimi i performancës në sektorin publik është një faktor i rëndësishëm për ta bërë ndryshimin në jetën e qytetarëve. Ky lloj auditimi i mban të fokusuar zyrtarët përgjegjës në sektorin publik për përdorimin e fondeve publike bazuar në parimin e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit. Me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe promovimit të standardeve më të larta për transparencë dhe llogaridhënie, Zyra Kombëtare e Auditimit i ka dhënë fokus të veçantë auditimeve të performancës. "Gjatë vitit 2018 janë publikuar 13 raporte të auditimit të performancës duke mbuluar fusha të rëndësishme si ekonomia dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, arsimit, mjedisi, teknologjia informative dhe prokurimi publik. Në këto auditime janë dhënë 175 rekomandime relevante për palët përgjegjëse. Rekomandimet kanë për qëllim përmirësimin e mangësive apo problemeve të identifikuara nga auditimet dhe zbatimi i tyre do të ndikojë pozitivisht në menaxhimin efikas dhe efektiv të programeve qeveritare dhe arrijen e vlerës për paranë e shpenzuar", është thënë në

njoftimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

ZKA-ja për përcaktimin e temave të auditimit të performancës për vitin 2018 ka zhvilluar një dialog efektiv me palët e interesit si Kuvendin, përkatësisht komisionet parlamentare, shoqërinë civile dhe donatorët. Sipas ZKA-së, kjo është bërë me qëllim që t'u përgjigjet në mënyrë adekuate pritjeve të palëve të interesit,

shqetësimeve të qytetarëve, si dhe rreziqeve të shfaqura ndaj mjediseve të ndryshme. "Kjo ka ndikuar që të rritet numri i raporteve të auditimit të performancës të shqyrtuara në komisione parlamentare dhe të rritet llogaridhënia në sektorin publik", është thënë në njoftimin për media.

Auditimet e performancës të kryera nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime të

pavarura, objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse sistemet, operacionet, programet dhe aktivitetet e institucioneve publike janë në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit, efektivitetit. Adresimi i rekomandimeve të auditimit ndihmon institucionet ta përmirësojnë performancën e tyre, të jenë më transparente dhe të arrijnë rezultate më të mira.



Ministri Tahiri: Do të rritet numri i zyrtarëve që do ta deklarojnë pasurinë

EPOKA E RE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të martën në takim këshilltarin e lartë për Masat Kundër Korrupsionit në Zyrën Qendrore të UNDP-së, Euywhan Kim, me të cilin ka biseduar për për-

mirësimin e infrastrukturës normative në luftën kundër korrupsionit. Ministri Tahiri ka vlerësuar mbështetjen që deri më tani UNDP-ja ka dhënë në përpjekjet e Republikës së Kosovës për të ndërtuar një qasje me zero tolerancë ndaj korrupsionit. Kjo mbështetje është duke vazhduar edhe në kuadër të agjendës

legjislative të Ministrisë së Drejtësisë.

Tahiri ka njoftuar përfaqësuesit e UNDP-së me orientimin e politikave publike të kësaj fushe, duke bërë me dije se në kuadër të Pakos së Ligjeve Kundër Korrupsionit është duke u punuar për hartimin e dy projektligjeve të reja, përkatësisht atij

për Deklarimin e Pasurisë dhe për mandatin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të cilat do të sjellin një perspektivë më të fuqishme që nxitë parandalimin efikas të abuzimit dhe keqpërdorimit me parandë publike.

Me këtë rast, ministri Tahiri ka njoftuar përfaqësuesit e UNDP-së se në këtë fushë janë paraparë

ndryshime përmbajtjesore, duke filluar nga rritja e numrit të zyrtarëve që do të deklarojnë pasurinë, te kontrolli efikas i të dhënave të deklaruara, deklarimi në formë elektronike dhe masat e tjera që do ta përcaktojnë qartë rolin dhe mandatin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, me fokus në parandalim.



KDI-ja: Gjakova, komuna më transparente, pasohet nga ajo e Rahovecit

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 SHKURT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në një konferencë për media mbajtur në Prizren ka bërë publike rezultatet e "Transparometrit komunal" edhe për gjashtë komuna të tjera më të mëdha të Kosovës, atë të Prizrenit, të Pejës, të Gjakovës, të Suharekës, të Rahovecit dhe të Deçanit.

Matja e transparencës është bërë bazuar në 59 indikatorë për periudhën janar - dhjetor 2018 dhe rezultatet e hulumtimit rendisin këto komuna si në vijim: Gjakova 99 pikë apo 83.89 për qind, Rahoveci 94 pikë apo 79.66 për qind, Peja 78 pikë apo 66.10 për qind, Prizreni 76 pikë apo 64.40 për qind, Suhareka 74 pikë apo 62.71 për qind edhe Deçani 67 pikë apo 56.77 për qind.

Naim Cahanaj nga KDI-ja ka thënë se transparometri ndjek një metodologji të matjes së indikatorëve në mënyrë objektive përgjatë katër shtyllave themelore të qeverisjes lokale. "Për shtyllën: Zyra e Kryetarit/es (15 indikatorë), për Kuvendin e Komunës (20 indikatorë), për Financat Komunale (8 indikatorë) dhe transparencën në Konsultime me Publikun (16 indikatorë)". Rezultati maksimal

që një komunë mund të arrijë është 118 pikë, ku secili indikator poentohet 0 deri në 2 pikë dhe i bie që me zero pikë të vlerësohet kur s'ka asnjë informacion, me një pikë informacionet e pjesshme dhe me dy pikë informacioni i plotë", ka theksuar ai. Kurse Almedin Fejza nga KDI-ja ka thënë se në shtyllën e "Kuvendit të Komunës", nga 40 pikët e mundshme të vlerësimit, Komuna e Gjakovës dhe ajo e Rahovecit janë radhitur më së larti me nga 36 pikë, pastaj ajo e Deçanit, Suharekës dhe Pejës me nga 31 pikë dhe Komuna e Prizrenit në këtë shtyllë është treguar me pak transparente me vetëm 29 pikë.

Në shtyllën e "Zyrës së Kryetarit/es" nga 30 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, si më transparente del të jetë Komuna e Gjakovës me 25 pikë, ku radhitet Komuna e Rahovecit me 22 pikë, e Suharekës me 18 pikë, e Pejës dhe e Prizrenit me nga 15 pikë, dhe më pak transparente ishte Komuna e Deçanit me vetëm 12 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë. Duke vazhduar me publikimin e të thënave për dy shtyllat e tjera të vlerësimit, ai ka thënë se Komuna e Gjakovës dhe e Prizrenit në shtyllën e "Financave komunale" janë



treguar më transparente gjatë kësaj periudhe, me vlerësim prej 13 pikësh nga 16 pikë sa është maksimalja në këtë shtyllë të vlerësimit. "Pas radhitet Komuna e Rahovecit me 12 pikë, Komuna e Pejës me 9 pikë, Komuna e Suharekës me 7 pikë si dhe në fund Komuna e Deçanit me vetëm 6 pikë. Në shtyllën e 'Konsultimet me publikun', nga

32 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, më transparente del të jetë Komuna e Gjakovës me 25 pikë, e Rahovecit me 24 pikë, e Pejës me 23 pikë, e Prizrenit me 19 pikë, e Suharekës dhe e Deçanit me nga 18 pikë", ka thënë Fejza.

Më 13 shkurt të këtij viti KDI pati publikuar "Transparometrin" edhe për 11 komuna të tjera më

të vogla. "Transparometri komunal" për gjashtë komuna u realizua në kuadër të projektit "Pjesëmarrja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie", i cili mbështetet nga Olof Palme International Center (OPIC), që ka për synim monitorimin dhe vlerësimin e transparencës dhe llogaridhënies nga institucionet vetëqeverisëse lokale.

Ligji për Qeverinë do ta zvogëlojë numrin e ministrive

Kryeministri Ramush Haradinaj ka marrë pjesë të martën në takimin e Komisionit Qeveritar për Hartimin e Projektligjit për Qeverinë. Ai ka thënë se është i inkurajuar me punën që ka bërë komisioni në këtë drejtim. Ndërkaq Besnik Tahiri, Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore, ka thënë se ky ligj trajton numrin e zëvendësministrave, të ministrive, njëkohësisht edhe të zëvendëskryeminstrove



ka thënë se bashkë me kryeministrin Haradinaj kanë takuar Komisionin Qeveritar për hartimin e Projektligjit për Qeverinë, që është hapi i dytë më i madh i reformave në administratën

e shtetit. Koordinator Tahiri ka theksuar se ky ligj e trajton numrin e zëvendësministrave, të ministrive, njëkohësisht edhe të zëvendëskryeminstrove, përgjegjësitë që i kanë të gjitha

resurset dhe në këtë drejtim kanë konsultim të mirë politik me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë për shkak se ky është ligji më vital, ose bazamenti i administratës shtetërore.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të martën në takimin e Komisionit Qeveritar për Hartimin e Projektligjit për Qeverinë, takim ky në të cilin kryeministri Haradinaj u njoftua nga të gjithë anëtarët për procedurat se deri ku ka shkuar ky proces. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se në kuadër të reformës shtetërore, pas pakos së tre ligjeve për shërbyesit civilë, për Administratën dhe Ligjit të Pagave që kanë qenë, po ashtu, me rëndësi, tashmë kanë hyrë në

një ligj jashtëzakonisht të rëndësishëm, ndoshta më i rëndësishmi se ato që kanë kaluar, pra është Ligji për Qeverinë.

Ndër të tjera, kryeministri Haradinaj ka theksuar se në Kosovë është krijuar një traditë dhe një njohje për qeverisjen dhe se tani e dinë të gjithë dhe janë nxjerr mësim se si duhet vepruar më tutje me qeverisjen në vend. "Jam i inkurajuar me punën që e ka bërë komisioni dhe besoj se prapë do t'i japin Kosovës Ligjin, ndoshta më të mirë për Qeverinë, në këtë rast që ka rajoni", ka vlerësuar kryeministri Haradinaj.

Besnik Tahiri, Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore,

Kimi viziton AKK-në, thotë se luftimi i korrupsionit është sfidë



PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka pritur të martën në takim këshilltarin e lartë politik nga Zyra për Politika Kundër-korrupsion, Qeverisje të Mirë dhe Ndërtim të Paqes nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Zyra Qendrore në Nju Jork, Euywhan Kim. Havolli ka bashkëbiseduar me Kimin për punën, mandatin dhe kompetencat e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe për ndryshimet legislative në drejtim të parandalimit dhe luftimit sa më efikas të korrupsionit në Kosovë. Po ashtu, Kimi është njoftuar për

metodologjinë e vlerësimit të legjislacionit që Agjencia Kundër Korrupsionit ka punuar konform përvojës së pranuar nga vizita studimore në Komisionin Kundër-Korrupsion dhe të Drejta Civile të Republikës së Koresë së Jugut.

Kimi, në anën tjetër, ka theksuar se parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është sfidë për të gjitha vendet e botës. Ai është shprehur i kënaqur me punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit në Kosovë dhe me rezultatet e arritura konform mandatis dhe kapaciteteve administrative që ka ky institucion.

Kimi vuri në theks përparësitë

e implementimit të masave preventive në përpjekjet e përbashkëta për luftimin e korrupsionit. Sipas tij, vlerësimi i legjislacionit, vlerësimi i integritetit të zyrtarëve, vlerësimi i integritetit institucional dhe individual, si dhe vlerësimi i riskut nga korrupsioni, janë disa prej mjeteve efikase të parandalimit të korrupsionit.

Kimi dhe Havolli u zotuan për bashkëpunim edhe në të ardhmen. Ndërkaq më 20 shkurt Kimi do t'i trajnojë zyrtarët e institucioneve të Republikës së Kosovës për hartimin e politikave dhe për zbatimin e masave parandaluese kundër korrupsionit.

Rashit Qalaj merr pjesë në 'Kongresin e Policisë Evropiane'

BERLIN, 19 SHKURT (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, i shoqëruar nga zyrtarë të lartë të PK-së, po merr pjesë në 'Kongresin e Policisë Evropiane', i cili po mbahet në Berlin të Gjermanisë, duke filluar nga sot e që do të zgjasë deri më 20 shkurt. Pjesëmarrja në këtë kongres, përveç të tjerash, do të shfrytëzohet edhe për rritje të bashkëpunimit të Policisë së

Kosovës me policitë evropiane në përgjithësi dhe me strukturat policore të Gjermanisë në veçanti. Përpos bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, vizita ka për qëllim shkëmbimin dhe rritjen e përvojave në parandalimin dhe luftimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në fushën e sigurisë, përfshirë terrorizmin, krimin e organizuar, krimin kibernetik, migrimin ilegal etj. Gjatë kësaj vizite do të synohet

edhe mundësia rreth shfrytëzimit dhe avancimit të teknologjisë për nevoja të institucioneve të zbatimit të ligjit. Pjesëmarrja në këtë kongres pritet të rezultojë me shkëmbimin e përvojave më të mira, ku të gjitha shtetet pjesëmarrëse, në veçanti PK-ja, gjatë pjesëmarrjes do të angazhohet maksimalisht për ta forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin me të gjitha shtetet pjesëmarrëse.



Ministri Lluka u jep mirënjohje minatorëve të 'Trepçës'

EPOKA E RE
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHKURT - Në shënimin e 30-vjetorit të grevës së minatorëve të "Trepçës", ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka dhënë mirënjohje për minatorët të cilët ishin pjesë e kësaj greve dhe po këtë vit dalin në pension. Këto mirënjohje u ndanë për kontributin e tyre të dhënë në minierën e "Trepçës" dhe për sakrificën e tyre gjatë grevës së 28 shkurtit të vitit 1989. Ministri Lluka falënderoi minatorët për punën dhe sakrificën e tyre dhe i njoftoi se përfitimet të cilat u takojnë atyre shumë shpejt do të zbatohen. "Kjo është një ceremoni falënderuese për punën e juaj, për jetën të cilën e keni kaluar në minierën e 'Trepçës', posaçërisht për sakrificën në grevën e minatorëve. Ju uroj për miratimin e statutit të 'Trepçës' e cila ju bënë hisedarë në këtë minierë. Ne jemi duke punuar që përfitimet të cilat ju takojnë të hyjnë në zbatim sa më shpejt dhe shpresojmë se brenda tre muajve të përfundojë procedura", është shprehur ministri Lluka.

Kryetari i Sindikatës së Minatorëve të Trepçës, Shyqyri Sadiku, u shpreh i kënaqur me kujdesin e treguar ndaj tyre nga ministri Lluka. "Falënderojmë ministrin Lluka i cili ka punuar shumë për 'Trepçën' dhe minatorët dhe është ministër i cili gjith-

monë u ka qëndruar afër minatorëve dhe për këtë gëzon respekt të veçantë të ne. Ne shpresojmë se shumë shpejt do të zgjidhet çështja e përfitimeve e cila do t'ju garantonte një pensionim më të mirë", ka thënë Shyqyri Sadiku. Ndërsa minatori më i vjetër i minierës "Trepça", Ferit Neziri, ka pohuar se Lluka është ministri i parë i cili i mbledhi minatorët në një ceremoni të tillë. "Unë si minatori më i vjetër i 'Trepçës' dua ta falënderoj për zemërsisht ministrin Lluka i cili është i vetmi prej ministrave që i ka mbledhur minatorët e 'Trepçës' në një ceremoni të tillë", është shprehur ai. Po ashtu, në shënimin e 30-vjetorit të grevës ishte i pranishëm edhe kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, i cili tha se "Trepça" dhe minatorët janë simbolikë e qytetit të Mitrovicës, duke i falënderuar minatorët për mundin dhe



punën të cilën e kanë bërë për minierën e "Trepçës".

Ndërsa minatorët i dhanë një dhuratë ministrit Lluka si shenjë

falënderimi për angazhimin dhe punën që ai ka bërë për ta.

Sot shënohet 30-vjetori i grevës historike të minatorëve

Sot (e mërkurë) në Stan Tërg shënohet 30-vjetori i grevës historike të minatorëve, të cilët më 20 shkurt të vitit 1989 u ngujuan në minierë, në shenjë revolte ndaj regjimit të asaj kohe.

Kryetari i Sindikatës së Minatorëve në "Trepçë", Shyqyri Sadiku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se të mërkurën, nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, do

të fillojë "Java e Minatorëve", e cila do të zgjasë deri më 28 shkurt. Ai ka treguar se me këtë rast do të ketë aktivitete të ndryshme. Sadiku ka theksuar se më 28 shkurt do të zbulohet pllaka me emrat e të gjithë minatorëve pjesëmarrës të grevës, i cili ka kujtuar këtë grevë të asaj kohe. "Atë ditë e kujtoj me shumë krenari dhe mburrje. Ka qenë një ditë kur unë kam filluar punën në ndërrim të

parë dhe për tetë ditë kemi hyrë në grevë urie. Greva kishte 11 kërkesa politike, sepse ishim të revoltuar nga regjimi i asaj kohe. Mund të them se nga ajo ditë kanë filluar të vihen themelet e shtetndërtimit të Kosovës, pasi me anë të asaj greve më pas u inspiruan dhe na përkrahën edhe studentët dhe profesorët. Jam krenar që i kam takuar atij brezi", ka thënë Sadiku.

Haradinaj priti në takim delegacionin e MCC-së nga Uashingtoni

PRISHTINË, 19 SHKURT - "Shumë inkurajues vlerësimi i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për progresin substancial të Kosovës në sundim të ligjit, zhvillim ekonomik dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale. Kjo është përkthyer me besimin e MCC-së që Kosova të tërheqë mjete nga programet Threshold dhe Kompakt", kështu tha kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi të martën priti në takim një delegacion nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) i kryesuar nga zëvendëspresidentja Karen Sessions. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj e ka falënderuar zëvendëspresidenten e MCC-së për kontributin e gjithanshëm që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin për popullin dhe shtetin e Kosovës. "Populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës për ndihmën që ShBA-ja ka dhënë për Kosovën, veçanërisht edhe përmes pro-



gramit të MCC-së, që mbështet përpjekjet e qeverisë për refor-

ma në fusha të ndryshme", tha kryeministri Haradinaj, i cili i

njoftoi të pranishmit për të arriturat e konsolidimit të shtetit.

Kryeministri Haradinaj në këtë takim ka përmendur edhe rëndësinë e madhe që ka për vendin ndihma e drejtpërdrejtë e MCC-së përmes programit Thresholds dhe tani përmes programit Compact, të cilin e ka fituar Kosova, duke thënë se institucionet e vendit dhe Qeveria do ta kenë përkushtimin e pakursyer në implementimin e këtij programi dhe këtij fondi. "Përkrahja e sektorit të energjisë dhe ekonomisë dhe e sektorëve të tjerë përmes këtij programi të MCC-së është tejet e nevojshme për Kosovën dhe ne do të qëndrojmë të përkushtuar që kjo të shënojë rezultat", tha kryeministri Haradinaj.

Nga ana e saj, zëvendëspresidentja Karen Sessions falënderoi kryeministrin Haradinaj për pritjen e sotme dhe shprehu gatishmërinë që bashkëpunimet në mes të MCC-së dhe Qeverisë të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

RRITEN PENSIONET

Qeveria e Kosovës ka vendosur të martën për rritjen e pensioneve bazike-sociale për 20 për qind, për pensionistët kontributdhënës 15 për qind dhe për pensionistët e parakohshëm të "Trepçës" për 20 për qind. Sipas një përlogaritje, i bie që pensionet e pleqërisë, ata që marrin nga 75 euro aktualisht, me buxhetin e ri do të marrin 90 euro, kurse pensionistët kontributdhënës, nga shuma prej 230 eurove, do të marrin 34 euro më shumë në muaj

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 SHKURT - Në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur të martën është marrë vendim për rritjen e pensioneve bazike-sociale për 20 për qind, për pensionistët kontributdhënës për 15 për qind dhe pensionistët e parakohshëm të "Trepçës" për 20 për qind. Rritja për pensionet në këto nënprograme është aprovuar me Ligjin për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Sipas një përlogaritje ende jozyrtare, i bie se pensionet e pleqërisë, ata që marrin nga 75 euro aktualisht, me buxhetin e ri do të marrin 90 euro, kurse pensionistët kontributdhënës, nga shuma prej 230 eurove, do të marrin 34 euro më shumë në muaj.

Numri i përgjithshëm i pensionistëve në Kosovë është 170 mijë. Prej tyre, 125 mijë janë shfrytëzues të pensionit të pleqërisë që marrin nga 75 euro në muaj, ndërsa 45 mijë janë kontribut-

pagues, që ndahen në katër kategori, të cilët marrin nga 158 deri në 230 euro në muaj në bazë të përgatitjes shkollore.

Miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe nisma e Ministrisë së Financave për negociimin e Marrëveshjes së Kredisë Eksportuese në mes të Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit "Krijimi i qendrave e-testuese dhe përmirësimi i mëtutjeshëm i shërbimeve të e-Arsimit për arsimin para universitar në Kosovë".

Qeveria ka themeluar komisionin për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike, i cili do të jetë përgjegjës për aprovimin, anulimin, ndryshimin dhe revokuimin e licencave për eksport, import, transit, transgarkim, ri-eksportim jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ri-transferim edhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura.

Miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-



2021.

Hartimi i kësaj strategjie adreson faktorët që kufizojnë rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardit të jetës dhe zhvillimin e ndërmarrjeve shumëdimensionale. Strategjia është prioritet i Qeverisë së Kosovës si dhe një nga proceset e identifikuar në procesin e përafrimit të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Vendimi preliminar për shpronësim me interes publik të pronave të cilat preken nga ndërtimi i autostradës Prishtinë - Pejë, në segmentin Kijevë - Klinë - Zahaq, është miratuar në mbledhjen e sotme. Edhe vendimi përfundimtar për shpronësimin e pronave që preken nga realizimi i projektit "Renovimi dhe ndërtimi i objekteve për nevoja të Selisë Qendrore të Federatës së

Futbollit të Kosovës" është miratuar nga Qeveria. Po ashtu, Qeveria e Kosovës ka aprovuar edhe koncept-dokumentin për shërbimet sociale dhe familjare. Koncept-dokumenti, krahas analizës së situatës në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, rekomandon ndryshimin e politikave me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore sociale dhe familjare për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Objektivi i përgjithshëm i identifikuar me këtë koncept-dokument është qëllimi i ofrimit të lehtë dhe të qashtë të shërbimeve për qytetarët me synim rritjen e cilësisë së tyre.

Ndërsa objektiva specifike janë: përcaktimi i përgjegjësive dhe kompetencave të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal dhe ofruesve të shërbimeve sociale

dhe familjare; përmirësimi i qasjes ndaj shërbimeve sociale dhe familjare duke i vendosur ato më pranë qytetarëve; klasifikimi dhe organizimi i shërbimeve sociale dhe familjare; rritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare; dhe financimi i qëndrueshëm i shërbimeve sociale dhe familjare.

Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe nismën për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Japonisë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për "Projektin për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë". Marrëveshja parasheh një grant për blerjen e pajisjeve për menaxhimin e mbeturinave në shumën prej 2.2 milionë eurosh.

Edhe dy investitorë përmbushin kriteret teknike, planifikojnë investim 225 milionë euro

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Të martën është mbajtur takimi i radhës i Komisionit Ndërmintor për Investime Strategjike, ku janë shqyrtuar kërkesat e dy investitorëve strategjikë dhe njoftimi për kompletimin e dokumentacioneve. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, që është edhe udhëheqës i këtij komisioni, tregoi se edhe dy investitorë të tjerë i kanë plotësuar kriteret teknike. "Edhe dy investitorë strategjikë i kanë përmbushur kriteret teknike për të kaluar në fazën tjetër të vlerësimit nga ana e grupit operacional të cilin e themeluan sot me vendim të Komisionit Ndërmintor për Investime Strategjike", ka thënë Shala. Subjektet aplikuese "Solar

Kosova 2020" dhe "KelKos-Energy Peja Sh.PK" planifikojnë të investojnë në Kosovë 225 milionë euro. "Solar Kosova 2020" planifikon investimin e 128 milionë eurove në Komunën e Obiliqit dhe "KelKos-Energy Peja SH.PK" 97 milionë në Komunën e Pejës. Të dyja këto projekte janë për energji alternative.

Shala ka theksuar se falë ndryshimeve të bëra në aktet nënligjore të Ligjit për Investime Strategjike, Kosova gradualisht po kthehet në vend atraktiv për investitorët e huaj. Këto dy investime që janë në procedurë e sipër dhe investimi i "SOWI Kosovo" L.L.C kapin vlerën e 394 milionë eurove dhe janë investimet e huaja më të mëdha direkte në Republikën e Kosovës.



Për tri ditë, 658 raste në Emergjencë

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - 658 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës gjatë tri ditëve të fundit. Në dhomën e kujdesit të avancuar mjekësor janë trajtuar 119 pacientë, kurse kishte 131 vizita kirurgjike. Brenda kësaj kohe janë

shënuar 216 raste internistike dhe 136 ortopedike. Sipas raportit të punës, 45 persona kanë kërkuar ndihmë për lëndimet e marra në aksidente komunikacioni. Me udhëzim të mjekëve, për trajtim të mëtutjeshëm, 74 persona janë shtrirë në klinika të ndryshme të QKUK-së.



Begaj e Minxhozi pajtohen për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta

MALISHEVË, 19 SHKURT (ER) - Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, ka vizituar të martën Komunën e Malishevës, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj. Siç ka njoftuar Komuna e Malishevës, kjo vizitë kishte karakter pune, përkatësisht bashkëpunimin në mes të kësaj komune dhe qyteteve në Shqipëri, në fushën e kulturës dhe organizimeve të përbashkëta me Ambasadën e Shqipërisë në Kosovë. Begaj dhe Minxhozi janë pajtu-

ar për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta në mes të Komunës së Malishevës dhe Ambasadës së Shqipërisë, për data dhe për ngjarje me rëndësi historike dhe kulturore, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit. Kryetari Begaj ka shprehur gatishmërinë e plotë të Komunës së Malishevës me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe të zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta në të gjitha fushat e jetës dhe për shkëmbim të përvojave me të gjitha qytetet në Shqipëri.



Ministri i Arsimit pret në takim kryetarin e Deçanit, flasin për zhvillimet në arsim

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, me të cilin ka biseduar për zhvillimet në arsim, në veçanti për të arriturat dhe vështirësitë në fushën e arsimit në këtë komunë. Bytyqi ka thek-

suar se Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë është gjithmonë e gatshme për të bashkëpunuar ngushtë me udhëheqësit e komunave pasi, sipas tij, ata i njohin më së miri vështirësitë në komunat që udhëheqin. "Duke bashkëpunuar në këtë mënyrë,

ne do të mund t'i zgjidhim problemet që mund të hasen, në kohë sa më të shkurtër. Po ashtu, i premtova kryetarit Ramosaj se MASHT-i do të angazhohet brenda mundësive që ka për përmirësimin e infrastrukturës shkollore në Komunën e Deçanit", ka thënë Bytyqi.



Shënohet 52-vjetori i themelimit të Gjinnazit në Skenderaj dhe ditëlindja e 69 e Hamëz Jasharit

SKENDERAJ, 19 SHKURT (ER) - Aktivitete të ndryshme janë organizuar të martën në Skenderaj me rastin e 52-vjetorit të themelimit të Gjinnazit "Hamëz Jashari" dhe datëlindjes së 69 të heroit kombëtar, Hamëz Jashari. Aktivitetet kanë nisur me homazhe dhe një minutë nderim të busti të Hamëz Jasharit para Gjinnazit, nga delegacioni i Komunës së Skenderajt i udhëhequr nga kryetari Bekim Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku, drejtorët komunalë, drejtorja e shkollës, profesorët dhe nxënësit. Nderime zyrtarë të lartë të Komunës së Skenderajt kanë bërë edhe në Kompleksin Memorial

"Adem Jashari" në Prekaz në shenjë respekti për sakrificën e tyre. Ndërsa në sallën e Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" në qytet, ku ishte i pranishëm edhe Rifat Jashari, vëllai i madh i Hamzës dhe Ademit, është mbajtur një program artistik, organizuar nga drejtorja e shkollës "Hamëz Jashari" dhe nxënësit e saj. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, duke uruar për ditën e shkollës, ka kujtuar babanë e tij, Hamëz Jashari, duke u shprehur falënderues për, siç ka thënë ai, vlerat e larta njerëzore të mësuara prej tij. "Ti dhe vëllai yt, që më vonë do të njihet si komandant legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bashkërisht ideologë të saj, u bëtë mësim

për gjeneratën tuaj dhe të tjerat që do t'ju pasojnë për atdheadashurinë. Ti më mësove mua dhe të tjerët se sa e vlefshme është liria, si mund të sakrifkohet për liri, sa shumë duhet të angazhohemi për ta ndërtuar vendin, për të tashmen dhe të ardhmen e fëmijëve tanë. Për çdo ditë mua më shumë më lartësohet personaliteti yt, i papërshtueshëm për mirësinë dhe thellësinë e mësimave me shembuj personalë. Do të jem përgjithmonë mirënjohës ndaj teje që më mundësove të vazhdoj gjurmëve tua në rrethana të reja, të ekzistoj dhe të shkruaj për ty, në atdheun tonë të dashur. Urime ditëlindja e 69, babë!", ka thënë kryetari Jashari.

Haremi i Mogerinit, me kalorës të lodhur!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Sevda çok, takat jok: Frederika Mogerini, mafioze politike në përfundim të karrierës në BE, së bashku me Johannes Hanin, Shtrausin e mashtrimeve, e plotësojnë me përsosmëri dyshen mafioze dhe bandite nga Perëndimi i Egër, Boni dhe Klajd. Shtrausi mashtrues nga Vjena, Johannes Hani disa herë ka bërë përpjekje ta bindë kryeministrin Haradinaj që ta largojë taksën për mallrat nga Serbia dhe Bosnja, pa ofruar asgjë konkrete si kompensim dhe këtë e ka bërë në mënyrë të paskrupullt dhe ultimative. As Daçiqi nuk ka qenë më i paskrupullt dhe më këmbëngulës kundër taksës sa ka qenë Shtrausi mashtrues, Johannes Han. Frederika Mogerini është tregim më vete. Sa i hapë sytë, pasi të jetë zgjuar e përsërit, sikur të ishte papagalle private dhe e certifikuar e Hashim Thaçit dhe Aleksandar Vuçiqit refrenin se: "Nuk ka vazhdim të bisedimeve, pa heqje të taksës..."!

Në një mënyrë është bërë kënd i trekëndëshit Thaçi - Vuçiq - Mogerini sepse gjithmonë flasin me një zë, sidomos rreth taksës dhe arritjes së një marrëveshjeje historike e cila, jo që nuk përfundon, por afirmon ndryshimin e kufijve, teritoreve, herë si korrigjim i lehtë e herë si diçka që është shumë e dhimbshme. Ky është treshi që ka krijuar vartësi ndaj njëri-tjetrit dhe duket se nuk munden pa njëri-tjetrin. Pikërisht për këtë arsye duan që marrëveshja të arrihet sa më parë pas së cilës, këto dy dyshe mafioze do të nominoheshin për Çmimin Nobel për Fizikë dhe Kimi për faktin se përmes një alkimie mashtruese duan që m...n ta shndërrojnë në mjalte e që askush nuk e ka bërë deri më sot. Thaçin dhe Vuçiqin po i krahasojnë me Tsiparisin e Greqisë dhe Zaevin e Vorio Maqedonisë, duke i marrë si shembull. Realisht, Zaevi nuk bëri asnjë sakrificë, vetëm e ndryshoi emrin

nga FYROM në Vorio Maqedonia. Çështje teknike që nuk ka pasoja politike e lëre më humbje të territorit. As Greqia nuk humbi asgjë, madje fitoi sepse e relativizoi identitetin kombëtar maqedonas, kurse Vorio Maqedoninë, sikur që Vorio Epirin e konsideron pjesë të Greqisë e jo të Shqipërisë, edhe Vorio Maqedoninë e konsideron pjesë të kamufliuar të Greqisë.

Realisht, humbësit më të mëdhenj që janë martirizuar për Marrëveshjen e Prespës janë shqiptarët të cilët nuk fituan asgjë dhe, me kalimin e kohës, do të relativizohen deri në marginalizim nga autoritetet e Vorio Maqedonisë të cilat asnjëherë nuk kanë qenë të disponuara miqësisht ndaj shqiptarëve. Tash është një qetësi relative derisa të arrihet një stabilizim në institucionet ndërkombëtare i këtij shteti fqinj me Kosovën e që, më vonë, pashmangshëm do të prodhojë probleme.

Frederika Mogerini, kjo mafioze politike e BE-së, armike e Kosovës dhe e shqiptarëve, hiç këtu Hashimin dhe një grup banditësh, ylli politik dhe ndikues i së cilës është në shuarje, përfunduar këtu Ariun e Madh (Hashimin) që i bindet, duke mos e kundërshtuar me asgjë, ka propozuar ta bëjë një sakrificë personale duke u mbyllur për tre (3) apo më shumë muaj vetëm me Hashim Thaçin dhe Aleksandar Vuçiqin, deri tek arritja e marrëveshjes përfundimtare, detyruese për Kosovën pas së cilës Kosova do të bëhej anëtare me të drejtë të plotë të votës së Shoqatës së Peshkatërëve në Gjylekar.

Frederika Mogerini po bën përpjekje ta bëjë një Big Brother Serbia, së bashku me Hashimin dhe të birin e Fahriut. Nëse Frederika Mogerini ka vendosur të ngujohet tre (3) apo më shumë muaj me Hashim Hashimin dhe Aleksandar Musliun për të diskutuar për arritje intelektuale, shkencore, filozofike, sociologjike, kulturore etj., atëherë ia ka qëlluar shenjës pikërisht në mes. Partnerë të nivelit të saj, në çdo aspekt për të diskutuar për këto tema, nuk mund t'i gjejë në asnjë vend të botës, madje as në Kazakistan apo Azerbajxhan. Nëse armikja e Kosovës dhe mikja e Serbisë, Frederika Mogerini, ka për qëllim që këta dy presidentë të Serbisë dhe Kosovës t'i përdorë

për relaksim fizik atëherë asgjë nuk do të ketë nga kjo punë sepse, përveç relaksimit intelektual, Hasha dhe Aca nuk mund të ofrojnë asgjë tjetër. Për relaksim fizik do t'i propozojë tarrakun e Opojës, Zafir Berishën, i cili, vetëm pas një jave ngujimi me Riken, do ta bënte mike të Kosovës dhe të shqiptarëve dhe do ta detyronte ta shlyente nga kujtimi emrin Hashim. Për ilustrim se si relaksimi fizik ndikon në ndryshimin e bindjeve politike dhe qëndrimit ua tregoj rastin e një italianit i cili pas përfundimit të luftës në Kosovë, i tmerruar nga skenat e dhunës, thoshte se duhet të përzihen të gjithë serbët nga Kosova dhe se Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë! Ishte i skajshëm në argumentim dhe në mbrojtje të asaj që e thoshte. Pas disa muajve e gjeti një banesë në Graçanicë dhe, pasi ia vari këmbët Jelicës për abazhur, filloi ta këndonte këngën: "Ko të kazhe, ko të plazhe, Serbia je malla..." (kush e thotë dhe kush gënjen se Serbia është e vogël).

Me një fjalë, për mosndryshim të kufijve dhe disiplinim të bandites politike serbe Frederika Mogerini, të gjitha shpresat i kam varur te Hashimi i Zafir!

Kushtrimi për heqjen e taksës nga Prekazi, na ngufati dhe na plasi: Hashim Thaçi, me kotillën politike që i shërben, shumica e deputetëve të PDK-së dhe vetë Kadria i PDK-së, po flasin me zërin e Hashimit, të Acës, Ivicës, Mogerinkës dhe Hanit (fesë), me zërin e adhuruesit të madh të Pllazma keksit, Jan Stoltenbergut, miqve të Putinit dhe Acës, Trampit dhe Boltonit dhe një aradhe të tërë. Në fillim, kur taksa e ringjalli krenarinë tepër të shkelur njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve, shumica u deklarua se janë baballarë të taksës dhe përbetoheshin se do ta mbrojnë këtë taksë deri në pikën e fundit të ujit "Rosa". E kishin hartuar një strategji ushtarake në krye me gjeneralin Ramiz Boro Kelmendi. Kur filluan të fryjnë erërat nga Atlantiku dhe Pacifiku, u krijua një situatë tjetër, e duan pezullimin e taksës dhe vendosjen e gazmaskës për t'u mbrojtur nga pordhët dhe fendët e këtyre patriotëve. Është interesant ecuria e përkrahjes dhe kundërshtimit të taksës. Hashim Thaçi është për heqje të taksës, i

shoqëruar nga kondomi, Bekimi. Kadria nuk po thotë se taksa duhet të hiqet, por se duhet të pezullohet për katër (4) muaj, kohë e paraparë për amortizimin e kundërshtimit të opinionit për marrëveshjen e nënshkruar midis Hashimit dhe Acës, disa muaj më parë. Shumë deputetë të PDK-së, të cilët Kadrinë më shumë e kanë thirrur Hashim se Kadri, tash thonë se ne e përkrahim propozimin e kryetarit Veseli, në emër të Hashimit. Nuk kanë guxim të dalin publikisht për heqjen e taksës, por se thirren në miqësi të përditshme me Amerikën kur edhe vetë e kanë të qartë se Amerika, shumë prej tyre i konsideron miq aq sa e ka konsideruar mik Al Kaponene dhe El Çapon të cilin e dërguan në Dubravën e Amerikës për pushim të përditshëm. Befasia më e madhe imja për taksën ishte qëndrimi i dy patriotëve me fletë; Behgjet Pacollit dhe Bekim Jasharit. Te Pacolli ende shumë shpresoj, por nuk e kam të qartë pse Bekim Jashari ta kërkojë pezullimin e taksës. Duket të ketë rënë nën ndikim të Ganës dhe Blertës, amazonave të partisë! Njeriu i parafundit, pas Ramushit, do të duhej të ishte Bekim Jashari që ta kërkojë heqjen apo pezullimin e taksës. Fort po i kruhet Bekimit për politika të larta ku, si Zeus po qëndron Hashimi! Në këto çaste vendimtare për kombin dhe Kosovën nuk më intereson fare qëndrimi i Milaimit, por se çfarë qëndrimi do të kenë Kamishi, Ismet Beqiri dhe Danushi. Për Begjen nuk e lodhi fare mendjen sepse jam i sigurt se, si gjithmonë do të qëndrojë i palëkundur në linjën kombëtare. Është njeri i vlerave të larta dhe i traditës! Për ta vërtetuar këtë ju tregoj lajmin e fundit që ma tha një mik imi kur e takova në shesh sepse, lexues të nderuar, me telefona dhe me nedë nuk i kam punët mirë andaj kërkoja sqarime orale. Më tha se Begja e paska dërguar një letër në adresë të liderëve kosovarë për një takim të ngutshëm me moton se: "Atdheu është në rrezik dhe se duhet të marrim vendime të mëdha..."

E pyeta se në cilën gjuhë e ka dërguar atë letër kurse miku im tha se e ka dërguar në gjuhën shqipe me alfabetin cirilik (për sqarim është alfabeti i Putinit, Acës dhe

Ivicës sikur edhe i Sheshelit). Po, kërkoja sqarim shtesë unë, si do ta kuptojnë liderët kosovarë letrën e shkruar me alfabetin cirilik kur, si patriotë të shquar i kanë lexuar veprat e klasikëve shqiptarë si; Afërdita përsëri në fshat, Lulja e Kujtimit, Sikur të ish djalë burrë) etj.? E kemi zgjedhjen tha se e paskan dërguar në LDK për ta bërë transkriptimin në alfabetin latin! Jemi me fat dhe gjendemi edhe në situata kur shpresa shndërrohet në shkronja! Shumë pres nga ky takim i patriotit Pacolli me bashkëpatriotët kosovarë dhe të tjerë kurse vendimi i parë i madh mund të jetë përpjekja për ta bërë Begjetin Ramush, apo edhe Shpendin. Nëse linguistët e LDK-së e përkthejnë si duhet letrën e dërguar nga Pacolli, patriot i shkëlqyer i kombeve dhe kombësive, atëherë dikush nga LDK-ja mund të ullet në karrigen e Ramushit ndonëse formati i prapanicës së tyre është më shumë për t'u ulur në oturak!

Në kohën kur në Kosovë festohej pavarësia, isha në Shqipëri ku cubat e Salës, Monikës dhe Lulit e dhunonin pavarësinë. Të shohësh se si, në emër të demokracisë, opozita bënte përpjekje të shkatërronte shtetin dhe institucionet e saj ishte diçka e tmerrshme. Të dëgjosh se si, po këta cuba, Sala, Monika dhe Luli thërrisnin për luftimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit krijonte përshtypjen se jemi duke jetuar në Panxhab apo një pjesë malore të Himalajave e jo në Shqipëri? A ka mbetur edhe një çikë morali në Shqipëri dhe vendet ku flitet shqip?!

Në krejt këtë tmerr ishte një vendim i shkëlqyer dhe largpamës i presidentit, përkatësisht Shkëlqesisë së Tij, zotëri Hashim Thaçi. Ishte dekorimi për meritat më të larta i një patrioti, humanisti, veprimtari, ideologu dhe udhëheqësit politik të njohur dhe pranuar, që nga Kosova deri në Egjipt. Ishte dekorimi i zotëri Danush Ademit udhëheqësit shpirtëror i rrymës dhe mendimit modern politik në Kosovë. Përgëzime për këtë veprim të jashtëzakonshëm për të mirën e njerëzimit, zotëri Hashim Thaçi, president që, më në fund, me të drejtë e vlerësive kontributin e një njeriu të jashtëzakonshëm!

Mustafa dhe Ahmeti flasin për krijimin e policisë së kryeqytetit

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, ka vizituar të martën Komunën e Prishtinës, ku është pritur nga kryetari Shpend Ahmeti, me të cilin ka diskutuar për temat e përbashkëta që kërko-

jnë angazhimin e dy institucioneve, me theks të veçantë për krijimin e policisë së kryeqytetit dhe për vendosjen e rregullit në trafik. "Në takim me kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, diskutuam për temat e

përbashkëta që kërkojnë angazhim të të dy institucioneve, me theks të veçantë për krijimin e policisë së kryeqytetit dhe vendosjen e rregullit në trafik", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".





—Saranda Bytyqi
Factory Manager & Quality Officer at Jaha Solar

WE

Women in Energy

are bringing new investors in the energy sector in Kosovo. Women in Energy Scholarship Program by MFK is helping to bridge the gap between the energy industry needs and the labour force.

Saranda Bytyqi is a 29-year-old Factory Manager and Production Quality Officer at the biggest solar panels producer in Kosovo, "Jaha Solar". She helped her company recruit workforce of over 50% women. She studied engineering and worked in several companies as an application engineer.

Learn about our scholarships and find out how to apply using the link below.

millenniumkosovo.org/womeninenergy

Find us at:
Millennium Foundation
Kosovo

9th floor of the former
Ljubljana Bank Building
Migjeni Str. 21,
10000 Prishtina,
Republic of Kosovo



E jashtëzakonshme

Policia daneze, në këmbë për një kangur

Policia daneze shpalli një kërkesë nëpërmjet një statusi në "Twitter", ku kërkon ndihmën e qytetarëve për kërkimin e një kanguri.

"Kanguri është larguar nga një shtëpi private në Rodding", ka thënë shefi i policisë, Henrik Sonderskov, për televizionin danez "TV2". Kjo nuk është hera e parë që një kangur largohet në këtë rajon të Danimarkës, rreth 80 kilometra në veri të kufirit me Gjermaninë. Në korrik të vitit 2018 një kafshë tjetër ishte zhdukur përpara se të gjendej nga pronarët.



FOTO E DITES



Një elefant shihet duke ecur në Colombi. /AFP/

BARSOLETA E DITËS



- O babë, na vodhi dikush veturën!
- A munde me pa kush ke?
- Jo, veç ia mora regjistrimin.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.


Regjia: Donovan Marsh



E rrallë

Godet të dashurin me mish derri, arrestohet

Një grua në Florida është arrestuar pasi goditi në fytyrë të dashurin e saj me një copë mish derri të ngrirë. Sipas zyrës së Sherifit të Qarkut Pasco, copa e mishit goditi viktimën 54-vjeçare në vetull, duke i shkaktuar plagë. E dashura e burrit, 48-vjeçarja J. B, iku menjëherë pas incidentit më 1 shkurt, ndërsa u kap nga policia një ditë më pas.



jëherë pas incidentit më 1 shkurt, ndërsa u kap nga policia një ditë më pas.



DASHI

Sot do të keni mjaft të papritura përgjatë ditës.


Nga ana sentimentale nuk do të ndiheni mjaft të kompensuar dhe kjo do t'ju mërzisë.



DEMI

Jeni tip ambicioz dhe sot do të bëni gjithçka që të dalë fjala juaj në fund.

Do të keni durimin që të dëgjoni me vëmendje një bashkëpunëtor.



BINJAKËT

Keni pasur disa probleme të vogla në fushën e financave, por sot do të zgjidhet gjithçka si me magji. Falë një këshille do të rikuperoni me kalimin e kohës.



GAFORRJA

Sot do të jetë një nga ato ditët që nuk do ta kujtoni aspak për mirë. Ngërçe dhe probleme në çdo fushë të jetës do t'ju nervozojnë.



LUANI

Do të jenë të tjerët që do t'ju tregojnë aftësitë dhe të metat tuaja sot. Keni kërkuar mendim nga persona që nuk janë shumë pranë jush për të qenë më realistë.



IRGJËRESHA

Keni gjetur ekuilibrin e duhur midis dashurisë dhe punës, partnerit dhe kolegëve. E vetmja gjë që duhet të rregulloni është përkushtimi familjar.



PESHORJA

Keqkuptimet në ditën juaj ju bëjnë t'i çoni mendimet te një ish-partner që nuk po arrini dot ta harroni. Por jeni mjaft kryelartë për ta pranuar.



AKREPI

Rutina dhe përditshmëria ju kanë lodhur shumë dhe doni të gjeni një moment hapësirë për t'u arratisur diku. Po bëni plane për një pushim të shkurtër.



SHIGJETARI

Keni vendosur të bëni një udhëtim për të parë vepra artistike dhe historike dhe nuk do t'ju mërziste aspak qëndrimi dhe shijimi i vetvetes.



BRICJAPI

Doni të mbyllni një marrëdhënie sentimentale që është ezauruar, por nuk po gjeni kurajën ta përballonni këtë bisedë me partnerin.



UJORI

Do të kalojë pak kohë përpara se ta rigjeni dashurinë në jetën tuaj. Megjithatë, si tipa të lirë që jeni, do të dini të argëtoheni me gjërat e tjera të jetës.




PESHQIT

Ju nuk prisni t'ju kthejnë mbrapsht atë që keni dhënë. Dhuroni pa interesa dhe kjo gjë ju bën më të lumtur e më të dashur.

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ATLETICO M. - JUVENTUS

X-X

SCHALKE - MAN. CITY

2-2

SEVILLA - LAZIO

X2

Majlinda, medalistja e olimpiadave policore

Majlinda Canolli është policja e Kosovës që po arrin shumë suksese në garat vendore dhe ndërkombëtare. "Kam marrë pjesë në gjysmemaratonën e Prishtinës dhe që disa vjet jam policja e parë vendore që e rrëmbej medaljen për kategorinë e polices. Këtë zakonisht e kanë bërë policet ndërkombëtare. Pastaj kam garuar në maratonën e Gjakovës në distancë 42 km, e cila për herë të parë është organizuar në vitin 2016 dhe aty jam renditur e para në kategorinë e veteraneve", ka thënë Canolli për "Epokën e re". Majlinda është e ftuar speciale në Olimpiadën Botërore të Policisë që do të mbahet në Kinë

EPOKA ERE

Liridon ZEQIRI

Prishtinë, 19 shkurt - Majlinda Canolli me sport ka filluar të merret që nga fëmijëria, kurse në vitin 2006 është bërë pjesë e Policisë së Kosovës dhe për një kohë të shkurtër ka arritur të regjistrojë rezultate shumë të mira. Medaljet që dikur i kanë rrëmbyer policet ndërkombëtare tash e kanë "pronare" Majlindën, e cila në vazhdimësi është duke i shtuar sukseset. "Prej kur jam inkuadruar në radhët e Policisë së Kosovës kam filluar aktivitetet fizike në vazhdimësi. Pjesëmarrjen në gara e kam vazhduar fillimisht në garat vendore duke filluar me vrapime të distancave të gjata 21 km, pastaj në maratonë 42 km, por u jam rikthyer edhe distancave të mëdha. Kam marrë pjesë në gjysmemaratonën e Prishtinës dhe që disa vjet jam policja e parë vendore që e rrëmbej medaljen për kategorinë e polices. Këtë zakonisht e kanë bërë policet ndërkombëtare. Pastaj kam garuar në maratonën e Gjakovës në distancë 42 km, e cila për herë të parë është organizuar në vitin 2016. Aty jam renditur e para në kategorinë e veteraneve", ka thënë Canolli për "Epokën e re".

Rezultatet e Majlindës nuk janë vetëm në rrafshin vendor, por policja e Kosovës e ka sfiduar veten edhe në garat ndërkombëtare. Si zakonisht, suksesi për të nuk ka munguar. "Duke iu falënderuar Policisë së Kosovës për mbështetje, deri tash kam marrë pjesë në dy gara ndërkombëtare të olimpiadave policore: në Olimpiadën Botërore që është mbajtur në Los Angeles dhe në



Olimpiadën Evropiane që është mbajtur në Algrecias të Spanjës, ku jam stolitur me disa medalje të arta dhe të argjendta. Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Sportit dhe Federatës së Atletikës në tetor kam marrë pjesë në maratonën e Brukselit si dhe në garat e organizuara në Shqipëri. Do të veçoja gjysmemaratonën e Tiranës dhe Beratit, ku aty jam pjesëmarrëse çdoherë", ka shtuar ajo.

Policja Majlinda Canolli ka zbuluar se

pas sukseseve të njëpasnjëshme është e ftuar speciale në Olimpiadën Botërore që do të mbahet në Kinë. "Meqenëse jam e vetmja medaliste e olimpiadave policore në shtetet e Ballkanit, sivjet jam e ftuar speciale në Olimpiadën Botërore të Policisë që do të mbahet në Chengdu të Kinës", ka thënë Canolli, e cila në lidhje me mbështetjen tregon se, përpos Policisë së Kosovës që ia mundëson ta përfaqësojë edhe jashtë Kosovës, nuk ka përkrahje tjetër.

SHKURT

Haradinaj e falënderon Arineta Mula për promovim të Kosovës

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka falënderuar për promovim të imazhit të Kosovës, alpinisten Arineta Mula. Pas një takimi të sotëm, Haradinaj ka thënë se "Flamuri i Kosovës po valon në majat më të larta botërore falë energjisë dhe përkushtimit të njerëzve të sfidave të mëdha si Arineta Mula". "Kënaqësi ta dëgjoj rrëfimin për përvojën e saj unike dhe ta falënderoj për promovimin e imazhit të Kosovës", ka shkruar Haradinaj. Mula më 2017 kishte arritur ta pushtonte Everestin, duke ngritur flamurin e Kosovës në majën më të lartë të botës.

Ramadani: Llapi, kundërshtar i fortë, por derbin e fitojmë ne

Feronikeli është lider në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, kurse ndeshjen e radhës e zhvillon ndaj Llapit në Drenas. Trajneri i "Niklit", Zekrija Ramadani, e ka vlerësuar shumë të vështirë ndeshjen ndaj Llapit, por pret që pikët e plota t'i takojnë skuadrës së tij. "Llapi në çdo ndeshje kontrolluese dhe në ndeshjen e parë kundër KEK-ut ka shënuar nga tre ose më shumë gola. Kjo na bënë që të jemi shumë të kujdesshëm, pasi bëhet fjalë për një ekip mjaft cilësor dhe që shënon shumë gola. Unë si trajner patjetër se pres një lojë të mirë nga futbollistët e mi dhe fitore, por do të jetë shumë e vështirë", ka thënë Ramadani për "Olle".

Napoli planifikon shitjen e Hysajt

Napoli po planifikon të "pasurohet" duke shitur disa prej yjeve të skuadrës. I pari në listë është sulmuesi Dries Mertens, kurse pas tij gjendet mbrojtësi shqiptar Elseid Hysaj. Kështu raporton "Il Mattino". Klauzola për largimin e Hysajt është 50 milionë euro. Deri më tani askush nuk është gati ta paguajë një shifër të tillë. Nisur nga sezoni aktual, që nuk ka qenë i mirë për shkodranin, vlera e Hysajt në treg ka pësuar rënie. Trajneri Carlo Ancelotti nuk e ka të preferuarin e tij dhe në këto kushte shitja e tij në verë është një opsion që po merret në konsideratë. Skuadrat që kishin shfaqur interesim për Hysajn ishin Bayern Munchen dhe Chelsea.

Qeveria bën shpronësimin e pronës për FFK-në

PRISHTINË, 19 SHKURT - Qeveria e Kosovës të martën e ka marrë vendimin përfundimtar për aprovimin e shpronësimit për interes publik të pronave të paluajtshme (ish-shoqërore) të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga real-

izimi i projektit "Renovimi dhe ndërtimi i objekteve për nevoja të selisë qendrore të Federatës së Futbollit të Kosovës", në zonën kadastrale në Prishtinë. FFK-ja tash do ta ketë pronën e vet dhe për herë të parë në histori do të mundësohet krijimi i një selie

moderne për futbollin e Kosovës. "Federata e Futbollit të Kosovës falënderon për përkrahje të vazhdueshme institucionet, duke filluar nga presidenti, kryeministri, kryeparlamentari e ministri i sportit, por edhe për bashkëpunim shumë të mirë të

gjitë kryetarët e komunave, ngaqë në këtë mënyrë po mundësohet krijimi i kushteve më të mira të infrastrukturës për rininë tonë, e cila është e mishëruar me futbollin", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit.



Serena Williamsi rikthehet në elitë pas 10 muajsh

WASHINGTON, 19 SHKURT - Tenistja amerikane Serena Williams është rikthyer në "top 10" tenistet më të mira në botë, për herë të parë pas më shumë se një viti. Ajo mori një pushim disamujor për shkak të shtatzënisë (lindi vajzë).

Fituesja e 23 grand slemeve zbriti deri në vendin 491 në mars 2018, kur dhe u rikthye në fushë. Gjatë muajve të fundit ajo arriti të shkojë deri në finale në dy grand slam, Wimbledon dhe US Open, por pa mundur t'i fitojë ato. Gjithsesi, paraqitja

e mirë dhe pikët e grumbulluara gjatë muajve të fundit i dhanë mundësi tenistes amerikane të bëjë një ngjitje të jashtëzakonshme në renditje. Tashmë ajo ndodhet në vendin e dhjetë, me 3 406 pikë. Në krye të renditjes botërore ndodhet

tenistja japoneze Naomi Osaka, që ka fituar dy turnetë e fundit grand slam. Ajo ka 6 970 pikë, ndërsa në vendin e dytë ndodhet tenistja rumune Simona Halep. Me këtë ritëm Williamsi mund ta synojë sërish kreun e renditjes botërore.



Berisha: Me përkrahjen e 'Dardanëve' do ta mposhtim Rumaninë

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në basketboll, Dardan Berisha, në një deklaratë të dhënë për Federatën e Basketbollit të Kosovës ka thënë se stërvitja e së martës ka qenë e mirë për faktin se ekipit përfaqësues i janë bashkangjitur edhe disa basketbollistë. "E kemi nisur të kompletuar, pasi ka ardhur edhe Malcolm. Po gëzohemi që ka ardhur edhe Rioni prej lëndimit. Jemi më të kompletuar. Është kthyer edhe Edmond Azemi, i cili do të japë edhe përvojë. Po për gatëmi shumë mirë. Po besoj se edhe lojtarët kanë luajtur nëpër ekipet e tyre, kështu që fizikisht jemi më mirë sesa që kemi qenë. Tani po e presim edhe listën [e lojtarëve të zgjedhur]", ka thënë Berisha, i cili beson se Kosova mund ta mposhtë Rumaninë të dielën në kryeqytet. "Jemi optimistë. Po besoj se do të fitojmë, por normalisht varet edhe nga Rumania, me çfarë ekipi vjen. Normalisht, ne do të jemi 100 përqind të përgatitur dhe do të japim gjithçka që ta fitojmë këtë ndeshje shumë me rëndësi për Kosovën, kështu që i kisha ftuar publikun, krejt 'Dardanët', të vijmë për të na përkrahur. Kjo do



të jetë një ndeshje shumë e rëndësishme për ne dhe unë po u premtoj të gjithëve se do ta japim 100 përqindëshin tonë për të fituar", ka deklaruar Berisha. Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll është grumbulluar të

hënën dhe ka nisur përgatitjet për duelin me Rumaninë që do të zhvillohet më 24 shkurt në orën 20:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë në kuadër të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021".

Sonte Atletico - Juve dhe Schalke - City

Ndeshje e veçantë do të jetë për sulmuesin e ri të Atleticos, Alvaro Morata, i cili në të kaluarën pati një përvojë fantastike në Juventus, kurse Cristiano Ronaldo rikthehet në Madrid për herë të parë pas transferimit në Serinë A

MADRID, 19 SHKURT (ER) - Juventusit në Spanjë do të përballë me Atletico Madridin në Ligën e Kampionëve sot (e mërkurë). Duke folur për faqen zyrtare të UEFA-s, sulmuesi Antoine Griezmann bëri një paralajmërim për Juventusin: "Ne kemi lojtarë që kanë luajtur tashmë në finalet më të rëndësishme në kompeticion në Evropë. Si Evropa Ligë dhe Kupa e Botës. Ne jemi tashmë më të sigurt kur përpara kemi ndeshje të rëndësishme dhe mendoj se mund të japim më të mirën nga vetja në këto raste. Ka fytyra të reja në ekip, por baza është gjithmonë e njëjtë dhe kjo do të na ndihmojë të shkojmë larg. Për momentin e konsideroj veten pjesë thelbësore të këtij projekti dhe kjo më ndihmoi të vendos, përveç faktit që unë kam mbështetjen e plotë të trajnerit, klubit dhe shokëve të ekipit tim", ka deklaruar Griezmann. Për ndeshjen që zhvillohet në Madrid foli edhe mbrojtësi i Juventusit, Leonardo



Bonucci. "Ne do të duhet të luftojmë për çdo top. Gjithmonë do të jetë një betejë kundër Atletico Madridit. Alvaro Morata? Është një mik yni, por unë e kam paralajmëruar tashmë", ka deklaruar mbrojtësi italian.

Lajm i mirë për skuadrën vendëse është rikthimi i Diego Costas dhe Stefan Saviqit, kurse mungesa e vetme pritet të jetë

Lucas Hernandez. "Zonja e Vjetër" do të jetë pa mesfushorin Juan Cuadrado. Krahas ndeshjes Atletico Madrid - Juventus, sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Schalke 04 dhe Manchester City.

SONTE TAKOHEN:
21:00 Atletico Madrid - Juventus
21:00 Schalke - Manchester City

SHKURT

LeBron në gjurmët e Jordanit

Ylli i Lakers, LeBron James, pas përfundimit të ndeshjes së "All Star Game", ka bërë me dije se ekziston mundësia në të ardhmen që ai të bëhet pronari i një prej 30 skuadrave të NBA-së. "Për mua, të jem pronari i një ekipi në NBA është si një frymëzim dhe besoj se mund të ndodhë. Kjo nuk është një gjë që e mendoj çdo ditë. Unë kam ende shumë vite për të luajtur basketboll para se të tërhiqem, ndaj kjo është një gjë që mund të ndodhë në të ardhmen", u shpreh LeBron Jamesi. Ai kërkon t'i ndjekë gjurmët e legjendës Michael Jordan, ikonës së NBA-së, që aktualisht është pronar i Charlotte Bobcats. Paratë nuk i mungojnë LeBronit, tri herë kampion në NBA, që ka edhe një kontratë të përjetshme me Nike.

Marcelo dëshiron largimin nga Reali

Marcelo nuk u aktivizua me Realin e Madridit gjatë muajit nëntor dhe dhjetor. Shkak ishte dëmtimi i brazilianit, por ai vazhdon të qëndrojë në stol edhe pas rikuperimit. Mbrojtësi i majtë e ka humbur vendin e titullarit dhe ka qëndruar në stol në gjashtë ndeshjet e fundit në mes të kampionatit dhe Ligës së Kampionëve. Ai ishte titullar në ndeshjen e fundit të humbur në shtëpi përballë Gironas, por kjo nuk mjafton dhe lojtari ka vendosur të largohet. Marcelo ka pasur një takim me drejtuesit e klubit. Siç raporton "Cadena Cope", 30-vjeçari ka kërkuar shitjen e tij në fund të sezonit. Kontrata me Realin i përfundon në vitin 2022, por e vështirë që ai të qëndrojë deri në fund të saj në kryeqytetin spanjoll. E ardhmja e brazilianit pritet të jetë Juventusit, aty ku e pret edhe miku i tij i ngushtë, Cristiano Ronaldo.

Ancelotti kërkon blerjen e Belottit

Trajneri Carlo Ancelotti ka kërkuar nga drejtuesit e Napolit që të transferohet një sulmues për sezonin e ri. Tekniku italian e pëlqen shumë sulmuesin e Torinos, Andrea Belottin. Për ta realizuar këtë transferim, Napoli duhet të paguajë 40 milionë euro. Para dy sezonesh, Torino kërkonte 100 milionë euro nga shitja e tij, por tani sulmuesi ka dështuar ta vazhdojë formën e lartë. Në listën e Ancelottit është edhe sulmuesi i Lazios, Ciro Immobile.

Superkupa e Spanjës me katër ekipe pjesëmarrëse

Superkupa në Spanjë do të pësojë disa ndryshime nga sezoni i ardhshëm, me katër ekipe pjesëmarrëse në ndeshjet që do të zhvillohen jashtë vendit, ka konfirmuar Federata e Spanjës.

Presidenti i Federatës, Luis Rubiales, ka konfirmuar se dy gjysmëfinalet dhe finalja do të luhen jashtë Spanjës vitin e ardhshëm, me dy ekipet lidere të tabelës në La Ligë dhe dy finalistët e Kupës së Mbretit që do të marrin pjesë. Sezonin e shkuar ishte hera e parë në të cilën një garë u zhvillua jashtë Spanjës, me ndeshjen e zhvilluar në Tangier të Marokut.

Bonucci: Për Juven e refuzova Realin

Qendërmbrojtësi italian i Juventusit, Leonardo Bonucci, ka thënë se e ka refuzuar ofertën e Real Madridit për t'u rikthyer sërish në Juventus. "A është e vërtetë që e refuzova Real Madridin? Po, është. Real Madridi më shikoi dhe kjo më bëri të ndihem shumë krenar, si dhe isha shumë i kënaqur që isha i kërkuar nga ai. Kjo do të thotë se unë kam punuar mirë gjatë viteve të fundit. Megjithatë, thirrja nga Juventusit dhe kthimi në atë që unë e ndiej si shtëpi të zemrës sime bëri që unë të vendosja se Juventusit ishte opsioni më i mirë për mua", ka thënë Bonucci.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Qëndresa" Sh.p.k Gllarevë, Klinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Kramovik komuna e Rahovecit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.03.2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Beni" në fshatin Kramovik komuna e Rahovecit do të organizohet debat publik nga kompania "Qëndresa" Sh.p.k Gllarevë, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit në Kramovik komuna e Rahovecit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Qëndresa Sh.p.k.

Blerim Thaqi

"Qëndresa" SH.P.K. Adresa: Gllarevë, 32000 Klinë, E-mail: info@qendresashpk-rks.com;
Tel. +383 (0) 44 23 64 93; +383 (0) 44 44 44 94; +383 (0) 44 44 41 86



Address: Bulevardi Isa Boletini Nr. 28
40000 Mitrovicë
Republika e Kosovës

C.no.283/18

THE BASIC COURT IN MITROVICA – BRANCH IN VUSHTRRI, general department, civil division, with judge Izet Gërguri, and court recorder Turkane Rrahmani, in the contested matter of claimant Vesna Grabovac, maiden name Jovanovic, from Ibarska Sllatina village, municipality of Leposaviq, represented by authorized representative, lawyer Rexhep Kaqaniku, Mitrovica, against respondent Dalibor Grabovac, with unknown address in Bosnia and Herzegovina, represented by temporary representative, lawyer Namon Merovci from Vushtrri, in relation to their divorce, on 06.02.2019 rendered this:

RULING

I. Respondent Dalibor Grabovac, with currently unknown address is **APPOINTED** lawyer Namon Merovci from Vushtrri as his temporary representative who will represent and defend the interests of respondent until the conclusion of this legal matter.

II. The claimant is **OBLIGED** to cover the costs of the temporary representative incurred during this legal matter.

Reasoning

Claimant Vesna Grabovac, maiden name Jovanovic, through her authorized representative, lawyer Rexhep Kaqaniku, on 20.06.2018 filed a claim for divorce against respondent Dalibor Grabovac, currently with unknown address, with temporary representative, lawyer Namon Merovci from Vushtrri.

During the preliminary session of 06.02.2019 the representative of claimant Vesna Grabovic, maiden name Jovanovic, lawyer Rexhep Kaqaniku, stated that since the claimant has a legal interest to legally divorce this marriage, which in fact has been terminated, in order not to drag the contested procedure, motioned the court to appoint a temporary representative of the respondent.

After the approval of claimant's proposal for the appointment of temporary representative and having contacted the economic chamber of Kosovo, the court appointed Namon Merovci from Vushtrri as temporary representative.

Therefore, pursuant to article 79, paragraph 3, item (a) of the Law on contested procedure, the court ruled as specified in the enacting clause of this ruling.

BASIC COURT IN Mitrovica – BRANCH IN VUSHTRRI
General – Civil Division
C.no.283/18, dated 06.02.2019

Judge
Izet Gërguri
/signed and stamped/

LEGAL REMEDY: This ruling cannot be appealed



Date: 14/02/2019

Office: +386 (0) 49 133 380; Mob: +386 (0) 49 332 336; +377 (0) 44 164 434; e-mail: itontranslations@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Albert Berisha shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

▶ Klaudia Uroshi shpall te pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

▶ Vaid Sopi shpall te pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

▶ Brahim Jashari shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

▶ Valbon Sezallari shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

▶ Valentina Ndrecaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

▶ Hajrim Halimi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

▶ Mëntor Hoxha shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHF "Ibrahim Fehmiu" Prizren

▶ Hajrie Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Sezair Surroi" Bellobrad

▶ Mihran Vasija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "Leke Dukagjini" Prizren.

▶ Fazli Berisha shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.

▶ Imer Maliqi shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme profesionale QKS Skenderaj.

▶ Shenaj Xhemili shpallë të pavlefshme dëftesën e I, II të Gjinnazit "Frang Bardhi" në Mitrovicë.

▶ N.SH. "Basha" shpallë të pavlefshme nr. e biznesit 70989271 me pronar Durim Basha Vushtrri.

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

C.nr.283/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri me procesmbajtësen Turkane Rrahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Vesna Grabovac e vajzërisë Jovanovic, nga fshati Ibarska Sllatina, Komuna e Leposaviqit, të cilin e përfaqëson me autorizim av.Rexhep Kaqaniku Mitrovica, kundër të paditurit Dalibor Grabovac, me adresë të panjohur në Bosnjë e Hercegovinë, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.Namon Merovci nga Vushtrria, lidhur me shkurorëzim, jashtë seance, me datën 06.02.2019, e mori këtë:

AKTVENDIM

I. Të paditurit Dalibor Grabovac, tani me adresë të panjohur **I CAKTOHET** përfaqësues i përkohshëm av.Namon Merovci nga Vushtrria, i cili do ta përfaqësojë dhe do të i'a mbroj interesat e të paditurit gjerë në përfundim të kësaj çështjeje juridike.

II.**OBLIGOHET** paditësja që të bartë shpenzimet në emër të përfaqësuesit të përkohshëm, aq sa do të krijohen në këtë çështje juridike.

Arsyetimi


Paditësja Vesna Grabovac e vajzërisë Jovanovic, përmes të autorizuarit të saj av.Rexhep Kaqaniku, me datën 20.06.2018, ka parshtruar padi për shkurorëzim, kundër te paditurit Dalibor Grabovac, tani me adresë të panjohur përfaqësuesi i përkohshëm av.Namon Merovci nga Vushtrria.

Në seancën përgatitore të datës 06.02.2019, përfaqësuesi i paditëses Vesna Grabovac e vajzërisë Jovanovic av.Rexhep Kaqaniku, ka deklaruar se meqenëse paditësja ka interes juridik qe kjo bashkësi martesore e pushuar faktikisht edhe juridikisht t'i jap fund të njëjtës e meqenëse të paditurit nuk i dihet adresa e saktë, e me qëllim që të mos zhgëzohet procedura kontestimore, i ka propozuar gjykatës që të njëjtit t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Pas aprovimit të propozimit të palës paditëse për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe pas kontaktimit të OAK-së, gjykata të paditurit Dalibor Grabovac, i caktoi përfaqësuesin e përkohshëm av.Namon Merovci nga Vushtrria.

Andaj, bazuar në nenin 79 par.3, pika (a) te LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.283/18, datë: 06.02.2019



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, nuk lejohet drejta e ankesë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Nationalni Koordinator za Kultur, Omladinu i Sport
National Coordinator for Culture, Youth and Sport

Bazuar në nenin 12, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në Vendimin e Qeverisë nr. 04/49, të datës 29.05.2018 si dhe në vendimin Nr.01/86 të datës 25.01.2019 për Aproximin e raportit të punës së vitit 2018 dhe Planit të veprimit të Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2019, me qëllim të realizimit të këtij plani përmes shërbimeve të veçanta, KNKRS bënë:

Vazhdimin e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Zyra e Kryeministrit
Njësia Organizative:	Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i punës:	Ekspertë të Jashtëm
Tarifa e shërbimit:	E negociuar
Raportoni :	Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Dy (2) muaj
Numri i ekzekutuesve:	143
Vendi:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e të angazhuarit për MSHV:

- Harton materialet e testeve për lëndët përkatëse;
- Bën konsultimin e plan-programeve;
- Përzgjedh përmbajtjet programore, të cilat ai/ajo i konsideron se duhet vlerësuar;
- Materialet e testeve i përgatit bazuar në plan-program;
- Konsulton tekstet shkollore;
- Dërgon materialet e testeve në formë elektronike dhe në letër të nënshkuar;
- Koordinon dhe ndihmon punën e tij/saj me grupin përkatës të ekspertëve të jashtëm;
- Detyrat dhe obligimet i dorëzon me afat kohor të zyrja e KNKRS;
- Secili material rishikohet dhe miratohet nga ekipi i lëndës përkatëse;
- Mban përgjegjësi për saktësinë e materialeve të dërguara;
- Jep përgjegjësi për çfarëdo lëshimi nga ajo që është caktuar me marrëveshje;
- Ofron informata për stafin brenda Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Harton raporte me shkrim për Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Kryen detyra të tjera të cilat lidhen ngushtë me përgaditjen e materialeve.
- Mban konfidencialitetin dhe materialin e hartuar.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në arsim;
- Të jetë i lëmisë/fushës përkatëse për të cilat është i thirrur për hartimin e materialeve;
- Të ketë përvojë në përpilimin e testeve në vlerësime të jashtme;
- Të njohë mirë kurrikulën dhe të ketë aftësi për hartimin e materialeve sipas hierarkisë së niveleve të dijës;
- Të njohë mirë përdorimin e kompjuterit;
- Të jetë person kredibil dhe konfident;
- Të respektojë marrëveshjen në përpikshmëri;

Si më sipër, KNKRS, bazuar në ligjet në fuqi, do të angazhojë Ekspertë të Jashtëm sipas fushave të poshtë shënuar:

Për Klasën I-II:

- 1 Ekspert/e i/e jashtëm (me përvojë pune në ciklin fillor);
- 1 Ekspert/e i/e jashtëm në fushën e Edukimit (me përvojë punë në ciklin e lartë);
- 1 Ekspert/e i/e jashtëm (Psikolog me përvojë pune në ciklin fillor);

Për Klasën III-V:

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e fillor);
- 1 Ekspert/e i/e jashtëm në fushën e Edukimit (me përvojë pune në ciklin e lartë);
- 1 Ekspert/e i/e jashtëm në Gjuhën Angleze (me përvojë pune në ciklin fillor);

Për Klasën VI-IX, Gjuhë Shqipe:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Gjuhë Serbe:

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Gjuhë Turke:

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Gjuhë Boshnjake:

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Matematikë:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Gjuhë Angleze:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Biologji:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Kimi:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Fizikë:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Histori:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën VI-IX, Gjeografi:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të ulët);
- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Gjuhë Shqipe:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Gjuhë Serbe:

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë punë në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Gjuhë Turke:

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Gjuhë Boshnjake:

- 2 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Matematikë:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Gjuhë Angleze:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Biologji:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Kimi:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Fizikë:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Edukatë Qytetare:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Sociologji:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Histori:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Gjeografi:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Teknologji e Informimit dhe Komunikimit:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Ekonomi:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Muzikë:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

Për Klasën X-XII, Art:

- 4 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e mesëm të lartë);
- 1 Ekspertë të jashtëm (me përvojë pune në ciklin e lartë);

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët e interesuar për angazhim, për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në;
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës, referenca dhe çdo dokument tjetër i cili demonstroi dhe vërtetoi përmbushjen e kriterëve të fushës përkatëse);
- Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime;
- Kopje të letërnjoftimit.

Dokumentacionet duhet të jenë në pliko (zarf) të mbyllur dhe të dorëzohen në Zyrën e Koordinatorit Nacional për Kulturë Rini dhe Sport/ Zyrën e Kryeministrit, sheshi Nëna Terezë, Ndërtesa e Qeverisë, kati VIII, zyra nr. 806/b ose përmes postës, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kompensimi është i negociueshëm.

Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë Rini dhe Sport/ZKM, mirëpret aplikimin nga të gjithë personat e gjinisë femërore dhe mashkullore, nga të gjitha komunitetet.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit: **038 200 14 060**

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për listën e ngushtë.

Vazhdimi i afatit të aplikimit është i hapur 7 ditë nga data e publikimit, nga data 20/02/2019 deri më datën 26/02/2019.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport
Nacionalni Koordinator za Kulturë, Omladinu i Sport
National Coordinator for Culture, Youth and Sport

Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona br. 03/1 -149 o civilnoj službi Republike Kosovo, na osnovu Zakona br. 04/1-077, o obligacionim odnosima, u Odluci Vlade br. 04/49 od 29.05.2018 i kao i u Odluci br.01/86 od 25.01.2019 za usvajanje izveštaja o radu za 2018. i Akcionog plana Nacionalnog koordinatora za kulturu, omladinu i sport za 2019.godinu, u cilju realizacije ovog plana kroz posebne usluge, KNKOS:

**Produženje javnog konkursa za Ugovor
o specijalnim uslugama**

Naziv institucije:	Kancelarija Premijera
Organizaciona jedinica:	Nacionalni Koordinator za Kulturë, Omladinu i Sport
Radno mesto:	Spoljni stručnjak
Tarifa usluga:	Pregovarana
Izveštava	Nacionalni Koordinator za Kulturë, Omladinu i Sport
Vrsta ugovora:	Ugovor o specijalnim uslugama – (SSU)
Trajanje ugovora:	Dva (2) meseca
Broj izvođača:	143
Mesto:	Priština

Država:

Dužnosti i odgovornosti angažovanih SSU:

1. Izrađuje materijale testova za relevantne predmete;
2. Vršiti konsultaciju planova i programa;
3. Bira programske sadržaje koje on / ona smatra da treba da se procene;
4. Materijale za testove priprema na osnovu nastavnog plana i programa;
5. Konsultuje školske udžbenike;
6. Šalje materijale testova u elektronskom obliku i potpisane na papiru;
7. Koordiniše i olakšava njegov/njen rad sa odgovarajućom grupom spoljnih eksperata;
8. Dužnosti i obaveze predaje u roku kancelariji NKKOS;
9. Svaki materijal je pregledan i odobren od strane tima relevantnog predmeta;
10. Odgovoran je za tačnost dostavljenih materijala;
11. Odgovoran je za bilo kakav propust u odnosu na ono što je fiksirano sporazumom;
12. Pruža informacije osoblju u okviru Kancelarije nacionalnog koordinatora za kulturu, omladinu i sport o izvršenju njihovih dužnosti i odgovornosti;
13. Sastavlja pisane izveštaje za nacionalnog koordinatora za kulturu, omladinu i sport.
14. Obavlja i druge poslove koji su usko povezani sa pripremom materijala.
15. Čuva poverljivost rad i izrađenih materijala.

Kvalifikacija, radno iskustvo i veštine:

- Univerzitetska diploma
- Najmanje 5 godina radnog iskustva u obrazovanju;
- Da je iz predmeta / relevantne oblasti za koju je pozvan/a za izradu materijala;
- Treba da ima iskustvo u sastavljanju testova po spoljnoj evaluaciji;
- Da dobro poznaje nastavni plan i da ima sposobnost za izradu materijala prema hijerarhiji nivoa znanja;
- Da dobro poznaje rad na kompjuteru;
- Da je kredibilna i poverljiva osoba;
